



Prania / Presence	29.12	2023	viti / year
Prirja / Reference			
Organ / Institution	SKPMSHCC	9759/2023	Sasia / Quantity
Organ / Institution			1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1360/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktar-Kryetare, Arben Mehmeti, Ardita Haxhnikaj-Demi-Anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1360/2023 të datës 31.10.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Institucioni i Avokatit të Popullit, në çështjen juridike, „*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2023, morri këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1360/2023 e datës 31.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit sipas Ndryshim Plotësimit të Akt Emërimit të datës 04.09.2017, në pozitën e punës „*Zyrtarë i Burimeve Njerëzore*” në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, më datë 15.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit Nr.207/2023 në Komisionin për Ankesa në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) lidhur me refuzimin e kërkesës për pushim vjetor nga Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Më datë 16.10.2023 Komisioni i Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit ka nxjerr Vendim me numër V.nr.07/2023 përmes të cilit e ka aprovuar ankesën e ankuesit lidhur me refuzimin e kërkesës për pushim vjetor nga Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit duke e kthyer në rishqyrtim kërkesën e pushimit vjetor, sipas kërkesës dhe datave të përshtatshme për ankuesin tek Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit

Ankuesi më datë 25.10.2023 përsëri ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit për aprovimin e shfrytëzimit të pushimit vjetor prej datës



30.10.2023 deri me date 17.11. 2023, mirëpo i njëjti me date 25.10.2023 përmes emailit i ka aprovuar pjesërisht kërkesën për pushim vjetor duke filluar nga data 30.10.2023 deri me date 03.11.2023.

Ankuesi me date 27. 11.2023 e ka njoftuar Komision për Ankesa të IAP se Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit nuk e ka zbatuar vendimin e Komisionit dhe po ashtu e ka njoftuar për aprovimin e pjesërisht të kërkesës për pushim vjetor gjegjësisht aprovim me tri opsione. Kryesuesi i Komisionit të ankesave me date 27.10.2023i ka kthyer përgjigje ankuesit përmes emailit duke e udhëzuar se nëse keni ndonjë ankesë ju duhet të veproni sipas rregullave të brendshme dhe të parashtroni ankesë në Komision përmes Zyres së Personelit .

Ankuesi i pakënaqur me aprovimin e pjesërisht të kërkesës për shfrytëzimin e pushimit vjetor dhe moszbatimin e vendimit të Komisionit të Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm me më datë 31.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6788/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi po ashtu i pakënaqur me aprovimin e pjesërisht të kërkesës për shfrytëzimin e pushimit vjetor dhe moszbatimin e vendimit të Komisionit të Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm me më datë 01.11.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuesit në Institucionin e Avokatit të Popullit. Ndërsa Këshilli nga kjo e fundit nuk ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër: VK/2023 dhe numër protokollit Nr.prot.7453/2023 të datës 14.12.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1360/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 6788/2023 të parashtruar nga ankuesi më datë 31.10.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Komunikimet elektronike të datës 25.10.2023; Kërkesën për pushim të datës 30.10.2023; Komunikimet elektronike të datave 26.10.2023, 25.10.2023 dhe 27.10.2023; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 04.09.2023; Vendimin me numër V.nr.07/2023 i datës 16.10.2023; Ankesën me numër Nr.207/2023 të parashtruar nga ankuesi më datë 15.09.2023 në Komisionin për Ankesa në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP); Komunikimet elektronike të datës 29.04.2022; Kërkesën për pushim të datës 04.05.2023; Komunikimet elektronike të datës 12.09.2022; Komunikimet elektronike të datës 12.09.2023; Kërkesën për pushim të datës 26.09.2022; Komunikimet elektronike të datës 05.06.2023; Kërkesën për pushim të datës 18.09.2023; Komunikimet elektronike të datës 05.06.2023; Kërkesën për pushim të datës 12.06.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.11.2023; Komunikimet elektronike të datës 21.11.2023; Vendimin me numër VK/2023 dhe numër të protokollit 7453/2023 të datës 14.12.2023; Ankesën me numër protokollit Nr.262/2023 të datës 01.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Ankesa në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e palejuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht duke ju referuar nenit 2 ku është përcaktuar se: „Ky ligj zbatohet për zyrtaren/in publik në institucionin publik të Republikës së Kosovës. 2. Përjashtimisht, marrëdhënia e punës së zyrtares/it publik rregullohet ndryshe, vetëm kur parashihet shprehimisht me këtë ligj. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë, dhe nenit 6 paragrafi 4 po të këtij ligji ku theksohet se: 4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë, rrjedhimisht Kolegji vlerëson se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë u mundëson institucioneve të pavarura kushtetuese përjashtimin e dispozitave të caktuara të këtij Ligji, për atë që të njëjtat mund të cenojnë pavarësinë e tyre të përcaktuar me Kushtetutë dhe rregullimin e funksionimit të administratës dhe organizimit të tyre të brendshëm përmes ligjeve dhe akteve të veçanta, kështu që Kolegji i Këshillit, në këtë rast do të vendos sipas dispozitave të Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe akteve të brendshme të Institucioneve të Avokatit të Popullit që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve civil të këtij institucioni

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara nga palët ka konstatuar se ankuesi _____ më datë 25.10.2023 ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit për aprovimin e shfrytëzimit të pushimit vjetor prej datës 30.10.2023 deri me date 17.11. 2023, mirëpo i njëjti me date 25.10.2023 përmes emalit i ka aprovuar pjesërisht kërkesën për pushim vjetor duke filluar nga data 30.10.2023 deri me date 03.11.2023. Ankuesi me date 27. 10.2023 e ka njoftuar Komision për Ankesa të Institucionit të Avokatit të Popullit se Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit nuk e ka zbatuar vendimin e Komisionit dhe po ashtu e ka njoftuar për aprovimin e pjesërisht të kërkesës për pushim vjetor gjegjësisht aprovim me tri opsione. Kryesuesi i Komisionit të ankesave me date 27.10.2023 i ka kthyer përgjigje ankuesit përmes emalit duke e udhëzuar se nëse kenë ndonjë ankese ju duhet të veproni sipas rregullave të brendshme dhe të parashtroni ankese në Komision përmes Zyrës së Personelit . Tutje në bazë të dëshmive të ofruara konkretisht emalit të datës 27.10.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm drejtuar ankuesit, ku i njëjti e njofton përsëri ankuesin se kërkesa për shfrytëzimin e pushimit vjetor i është aprovuar pjesërisht si dhe e ka udhëzuar se në rast pakënaqësie mund të ushtrojnë të drejtën e ankimit në Komisionin e Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Mbi bazë të provave të lëndës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se ankuesi me datë 31.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër _____ ka parashtruar ankesë me numër _____ protokollin 6788/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datën 01.11.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa në Institucionin e Avokatit të Popullit, lidhur me moszbatimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit nga Sekretari i Përgjithshëm të datës 16.10.2023 dhe aprovimit të pjesërisht të kërkesës për pushim vjetor të datës 25.10.2023.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, analizozi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 135 paragrafi 1, është përcaktuar se: “Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës”, dhe

rrjedhimisht duke marr parasysh konstatimin si me lartë se ankuesi më datë 31.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 01.11.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa në Institucionin e Avokatit të Popullit, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit është e paraafatshme në kuptim të nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe dispozitave të nenit 125 paragrafi 1 dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1360/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së
-

